

DIJA bën pjesë në resurset më të rëndësishme, ndërsa arsimit është shtytësi kryesor për zhvillimin e një shoqërie.

RESURSET ARSIMORE janë mjete dhe materiale që përdoren në procesin arsimor.

RESURSET E HAPURA ARSIMORE (RHA) janë mjete dhe përmbajtje arsimore të lira për përdorim. Ato janë vegla pa pagesë që mund të shfrytëzohen për qëllime edukative dhe hulumtuese pa asnjë kompensim, edhe atë:

- ▶ libra mësimorë
- ▶ fletore pune
- ▶ doracakë
- ▶ fjalorë
- ▶ studime
- ▶ programe kompjuterike

INTERNETI DHE MJETET DIGJITALE janë veglat më të fuqishme të RHA-ve të cilat në të ardhmen do të fitojnë në rëndësi dhe efektivitet.

Digjitalizimi i arsimit duhet të jetë prioritet në digjitalizimin e shoqërisë.

Në procesin e digjitalizimit të arsimit, qasja e hapur është komponentë kyçe.

SHOQËRITË MODERNE DHE BOTA NË TË CILËN JETOJMË, TËRË ZHVILLIMIN E SAJ E MBËSHTESIN NË DIJE. PA MARRË PARASYSH SE A BËHET FJALË PËR TEKNOLOGJINË E ZHVILLUAR, MEDICINËN, BIOLOGJINË, ASTRONOMINË, E KËSHTU ME RADHË, TË GJITHA ARRITJET E NJERIUT BAZOHEN NË DIJE. DIJA NË EKONOMI, SOCIOLOGJI, PSIKOLOGJI DHE SHKENCAT E TJERA, KA NDIKIM TË MADH NË KUALITETIN E JETËS SONË.

- ▶ shërbime në internet
- ▶ platforma onlajn
- ▶ softuer dhe programe kompjuterike
- ▶ banka digjitale
- ▶ baza digjitale

▶ PSE RHA?

- ▶ RHA-të mundësojnë qasje të lirë deri te dija, pa asnjë diskriminim në çfarëdo baze, nga ajo gjeografike deri te ajo sociale dhe ekonomike.
- ▶ RHA-të mundësojnë kreativitet në procesin e mësimin dhe të risive.
- ▶ Kreativiteti dhe risitë hapin lloje të reja komunikimi me nxënësit dhe studentët, me çrast i nxisin dhe i aktivizojnë ata gjatë procesit arsimor.
- ▶ RHA-të i zvogëlojnë harxhimet e nxënësve, studentëve dhe organizatave të ndryshme.
- ▶ Kontributi për RHA-të do të thotë edhe kontribut për thesarin botëror të njohurive të përbashkuara, me çrast promovohen edhe parimet e arsimit të hapur.
- ▶ RHA-të e nxisin zhvillimin e softuerit të lirë dhe zbatimin e tij efikas në arsim.
- ▶ RHA-të e ndihmojnë zhvillimin e shoqërive, e përforcojnë kuadrin profesional dhe kapitalin arsimor.

▶ QËLLIMET E RHA-VE

- ▶ përpilimi i teksteve mësimore dhe i doracakëve të lirë për përdorim (që mund të shfrytëzohen pa pagesë),
- ▶ organizimi dhe sistematizimi i mjeteve dhe i materialeve arsimore që ato të mund të gjenden lehtë,
- ▶ lehtësimi i parimeve për shumëzimin e materialeve dhe rregullimin e të drejtave autoriale për këto përmbajtje,
- ▶ krijimi i komuniteteve onlajn të edukatorëve, arsimtarëve, profesorëve, hulumtuesve, etj.

TË DREJTAT AUTORIALE

RHA-të kërkojnë një qasje më praktike ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore mbi materialet arsimore dhe si ato të mos paraqesin pengesë për arsimin, si dhe shpërndarjen e dijes.

"CREATIVE COMMONS" janë licenca që mundësojnë mbrojtje të veprave autoriale nga përdorimet e padëshiruara, por njëkohësisht e nxisin bashkëpunimin, përmirësimin e njohurive, kreativitetin dhe sasinë e përmbajtjeve që në përgjithësi janë në dispozicion në internet. Krijuesit e resurseve arsimore shpesh i shfrytëzojnë këto licenca që t'i bëjnë ato resurse të hapura për të gjithë, dhe njëkohësisht të lejohet ripërdorimi i tyre në mënyrë legale.



Copyright
Të gjitha të drejtat janë të ruajtura

Creative Commons
Disa të drejta janë të ruajtura

Public Domain
Asnjë e drejtë nuk është ruajtur

QASJA E HAPUR, që angazhohet për prodhimin e materialeve hulumtuese me kualitet të lartë dhe shpërndarjen e tyre të lirë në internet, së bashku me RHA-të, janë shtytësit kryesorë të veprimtarisë shkencore-hulumtuese dhe arsimore.